



Co-funded by
the European Union

RAPORT PAS KONFERENCËS

Avancimi i qasjes në drejtësi
për të mbijetuarit e dhunës
seksuale të luftës:

*Përgjegjësia penale dhe e
drejta për kompensim*



Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë dhe e vetme e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT). Raporti është realizuar në kuadër të projektit Enhancing Transitional Justice Effectiveness, mbështetur nga Global Initiative Against Impunity (GIAI).

© Të drejtat autoriale i përkasin QKRMT-së. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar, qoftë origjinal ose i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen nga QKRMT.

Ky publikim është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e QKRMT-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

HYRJE



FERIDE RUSHITI
Drejtoresh Ekzekutive, QKRMT

Më 14 prill 2026, në Ditën Memoriale të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës së Fundit në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës [QKRMT] organizoi Konferencën Rajonale me temën “Avancimi i qasjes në drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës”, duke mbledhur në Prishtinë përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, ekspertë ligjorë, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë rajonalë nga Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia. Ishte hera e parë që në Kosovë mbledhen gjyqtarë dhe prokurorë nga rajoni për të diskutuar për krimet e luftës.

Konferenca u vlerësua si një moment i domosdoshëm për rikthimin në qendër të vëmendjes së çështjes së drejtësisë për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës. U theksua se ky takim nuk përbënte vetëm një aktivitet institucional, por një angazhim të qartë për të adresuar boshllëqet ekzistuese në sistemet e drejtësisë dhe për të nxitur qasje më të drejtë, më njerëzore dhe më gjithëpërfshirëse.

Gjatë punimeve u nënvizua se drejtësia nuk mund të kufizohet në ndjekje penale të autorëve të krimeve, por duhet të përfshijë edhe njohjen institucionale të përjetimeve, qasjen në reparacione efektive, mbështetjen e vazhdueshme psikosociale dhe rikthimin e dinjitetit të të mbijetuarve.

U rikujtua se 14 Prilli përbën jo vetëm një ditë përkujtimi, por edhe një thirrje për përgjegjësi të vazhdueshme kolektive ndaj mijëra grave dhe burrave që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë. U theksua se guximi i të mbijetuarve për të thyer heshtjen ka luajtur rol vendimtar në ndryshimin e diskursit publik, në sfidimin e stigmatizimit dhe në avancimin e proceseve të drejtësisë.

Konferenca u zhvillua në një atmosferë serioze bashkëpunimi rajonal, duke mundësuar shkëmbimin e përvojave ndërmjet gjyqtarëve, prokurorëve dhe ekspertëve të angazhuar në trajtimin e krimeve të luftës, veçanërisht rasteve të dhunës seksuale. Diskutimet sollën në pah sfidat praktike dhe institucionale, përfshirë standardet e provave, pengesat procedurale, kompensimin e viktimave dhe nevojën për qasje të ndjeshme ndaj traumës në proceset gjyqësore.

Një dimension i veçantë i Konferencës ishte përfshirja e drejtpërdrejtë e zërave të të mbijetuarve, të cilët rikujtuan se drejtësia nuk përfaqëson vetëm llogaridhënie juridike, por edhe një proces thelbësor të shërimit, njohjes dhe rikthimit të dinjitetit. Gjithashtu, përmes kësaj Konference u riafirmua rëndësia e forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe institucional, si dhe e avancimit të qasjeve të orientuara drejt viktimës në trajtimin e krimeve të dhunës seksuale të luftës.

Për fund, u shpreh mirënjohje të thellë, të gjithë pjesëmarrësve për bashkëpunimin dhe profesionalizmin e treguar, gjatë punimeve të kësaj konference. Edhe pse ky raport pasqyron një sërë shembujsh të ndikimit pozitiv, matja e vërtetë e suksesit të saj qëndron në mënyrën se si njohuritë, përvojat dhe rekomandimet e ndara do të shndërrohen në veprime konkrete në vijim, në funksion të avancimit të drejtësisë për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës.

✦ KONTEKSTI

Shoqëritë e pas-luftës në Ballkanin Perëndimor vazhdojnë të përballen me sfida të konsiderueshme në trajtimin e krimeve të luftës. Pavarësisht përparimeve në përpjekjet për llogaridhënie, dhuna seksuale në kohë lufte, mbetet ndër krimet më pak të ndjekura penalisht, ndërsa të mbijetuarit vazhdojnë të përballen me barriera sistemike në qasjen në drejtësi, mbrojtje dhe reparacione.

Megjithëse në vitet e fundit janë bërë hapa të rëndësishëm në ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe në njohjen institucionale të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, drejtësia për viktimat ende mbetet e paplotë pa realizimin efektiv të së drejtës për kompensim.

E drejta për kompensim konsiderohet një komponent thelbësor i drejtësisë tranzicionale dhe një standard i njohur ndërkombëtarisht në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Megjithatë, në praktikë, të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës vazhdojnë të përballen me vështirësi të shumta në realizimin e kësaj të drejte. Procedurat komplekse gjyqësore, udhëzimi i palëve në kontest civil, mungesa e harmonizimit të praktikave gjyqësore, si dhe sfidat në ekzekutimin e kompensimit, mbeten pengesa serioze për realizimin e të drejtës në kompensim.

Përvojat rajonale kanë dëshmuar se përfshirja e kompensimit brenda procedurave penale, si pjesë e aktgjykimit penal, mund të luajë rol të rëndësishëm në shmangien e barrës shtesë mbi viktimat dhe në sigurimin e një forme më të plotë të drejtësisë. Në këtë kontekst, gjyqtarët dhe prokurorët kanë një rol kyç jo vetëm në sigurimin e llogaridhënies penale, por edhe në avancimin e jurisprudencës që njeh dhe garanton të drejtat e viktimave, përfshirë të drejtën për kompensim dhe reparacion efektiv. Për më tepër, zhvillimi i qasjeve të orientuara drejt viktimës dhe të ndjeshme ndaj traumës është thelbësor për të parandaluar ritraumatizimin dhe për të siguruar trajtim dinjitoz të të mbijetuarve gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Duke pasur parasysh këto sfida dhe nevoja, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës [QKRMT] organizoi Konferencën Rajonale “Avancimi i qasjes në drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës”, me qëllim të krijimit të një platforme rajonale për shkëmbimin e përvojave, diskutimin e praktikave gjyqësore dhe avancimin e dialogut profesional mbi drejtësinë, reparacionet dhe mbrojtjen e të drejtave të të mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës.

Objektivat e Konferencës

- ✘ Shkëmbimi i përvojave dhe mësimave të nxjerra ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar në rastet e krimeve të luftës dhe dhunës seksuale.
- ✘ Adresimi i sfidave kryesore në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e këtyre krimeve, përfshirë çështjet procedurale.
- ✘ Shqyrtimi i kornizave ekzistuese të reparacioneve dhe kompensimit për të mbijetuarit, përfshirë mekanizmat gjyqësorë dhe administrativë.
- ✘ Promovimi i qasjes së ndjeshme ndaj traumës dhe të orientuar drejt të mbijetuarit në proceset gjyqësore.

✦ PËRMBLEDHJE

Më 14 prill 2026, në shënimin e Ditës Memoriale të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës së Fundit në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës organizoi Konferencën Rajonale me temën “Avancimi i qasjes në drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës”. Konferenca mbledhi gjyqtarë, prokurorë, ekspertë ligjorë, përfaqësues institucionalë dhe organizata të shoqërisë civile nga Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia, me qëllim të shkëmbimit të përvojave rajonale dhe diskutimit të sfidave në trajtimin e krimeve të dhunës seksuale të luftës.

Konferenca u zhvillua në një ditë me rëndësi të veçantë simbolike dhe shoqërore për Kosovën, duke krijuar një hapësirë reflektimi dhe dialogu profesional mbi nevojën për drejtësi gjithëpërfshirëse, llogaridhënie institucionale dhe reparacione efektive për të mbijetuarit.

Në fjalën e saj përshendetëse, Drejtorja Ekzekutive e QKRMT-së, Dr. Feride Rushiti, e cila nënvizoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe nevojën për qasje të orientuara drejt viktimës në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë luftës. Ajo theksoi se progresi në fushën e drejtësisë kërkon jo vetëm angazhim institucional të qëndrueshëm, por edhe ndjeshmëri të lartë ndaj përjetimeve të të mbijetuarve, duke e vendosur dinjitetin e tyre në qendër të çdo procesi.

Fjalime përshendetëse mbajtën gjithashtu përfaqësues institucionalë, përfshirë Ardian Gola, nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili ritheksoi rëndësinë e konsolidimit të mekanizmave të llogaridhënies dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në trajtimin e krimeve të luftës. Ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla-Schwarz, nënvizoi nevojën për angazhim të vazhdueshëm institucional në garantimin e qasjes në drejtësi, reparacione dhe mbështetje për të mbijetuarit, duke ritheksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përkushtimit të qëndrueshëm shtetëror në adresimin e krimeve të luftës. Ndërsa Mirjeta Shala, anëtare e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, vuri në pah rolin e gjyqësorit në garantimin e proceseve të drejta, të paanshme dhe të ndjeshme ndaj traumës, duke ritheksuar përkushtimin institucional për forcimin e besimit në sistemin e drejtësisë. Në të gjitha adresimet u reflektua një qëndrim i përbashkët institucional mbi domosdoshmërinë e avancimit të drejtësisë për të mbijetuarit dhe fuqizimin e qasjeve që e vendosin viktimën në qendër të procesit.



Zëri i të mbijetuarve

Pjesë e rëndësishme e Konferencës ishin reflektimet personale nga të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës, të cilët i dhanë konferencës një dimension të fuqishëm njerëzor dhe rikujtuan rëndësinë e vazhdimit të përpjekjeve për drejtësi dhe dinjitet.



Vasfije Krasniqi

Vasfije Krasniqi ndau rrëfimin e saj personal dhe rëndësinë e thyerjes së heshtjes publike:

“Sot është 14 prill. Një datë që për shumëkënd është thjesht një ditë e radhës në kalendar... por për mua, është dita kur jeta ime ndryshoi përgjithmonë. Isha vetëm 17 vjeç kur kërkova drejtësi, por kjo drejtësi më u mohua. Megjithatë, unë nuk heshta. Në vitin 2018, vendosa të flas publikisht dhe sot ndihem krenare që, falë asaj nisme, katër raste të tjera kanë arritur të fitojnë drejtësinë e merituar.”



Shyrete Tahiri

Në vazhdim, **Shyrete Tahiri** theksoi rëndësinë e këmbënguljes për drejtësi dhe inkurajimit të të mbijetuarve të tjerë për të mos heshtur:

“Unë e kam bërë hapin tim, kam kërkuar drejtësi dhe asnjëherë nuk do të dorëzohem derisa të arrij drejtësinë dhe nuk dua që askush tjetër të mbetet i heshtur siç kam qenë unë. Sot ju inkurajoj: bëjeni edhe ju hapin tuaj. Kërkoni drejtësi.”



Ramadan Nishori

Po ashtu, **Ramadan Nishori** foli për rëndësinë e së vërtetës, drejtësisë dhe rikthimit të dinjitetit:

“Mos e mbani të vërtetën tuaj në heshtje. Mos lejoni që frika apo paragjykimi t’ju ndalojnë. Kërkoni drejtësi. Sepse drejtësia është pjesë e shërimit dhe rikthimit të dinjitetit tonë!”

Këto dëshmi u reflektuan gjatë gjithë konferencës si rikujtim se drejtësia për të mbijetuarit nuk lidhet vetëm me procedurat ligjore dhe llogaridhënien penale, por edhe me njohjen publike, rikthimin e dinjitetit dhe fuqizimin e zërit të tyre në shoqëri.

✦ DISKUTIMET NË PANELE



Paneli i parë trajtoi temën “Krimet e luftës të dhunës seksuale: nga jurisprudenca te kompensimi – sigurimi i drejtësisë gjithëpërfshirëse”. Diskutimet u zhvilluan rreth zhvillimeve të deritanishme jurisprudenciale në rajon, duke analizuar mënyrën se si rastet e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin janë trajtuar në praktikat gjyqësore dhe çfarë mësimesh mund të nxirren nga përvojat e deritanishme. Një pjesë e rëndësishme e diskutimit iu kushtua sfidave të vazhdueshme procedurale dhe

standardeve të provave, përfshirë kompleksitetin e ndërtimit të rasteve pas shumë vitesh nga kryerja e krimeve, si dhe nevojën për qasje më të unifikuar dhe më të ndjeshme në nivel rajonal.

U theksua se këto raste kërkojnë jo vetëm ekspertizë të lartë juridike, por edhe qasje të kujdesshme që e njej natyrën e traumës dhe vështirësitë e dëshmimeve të mbijetuarve. Në këtë kontekst, u trajtua edhe rëndësia e praktikave të mira gjyqësore që kontribuojnë në forcimin e besimit në sistemin e drejtësisë. Po ashtu, u nënvizua se kompensimi i të mbijetuarve përbën një element thelbësor të drejtësisë gjithëpërfshirëse, i cili duhet të jetë i integruar në mënyrë efektive si në proceset gjyqësore ashtu edhe në skemat shtetërore të reparacioneve, duke garantuar njohje dhe adresim të dëmit të shkaktuar.

Paneli përbëhej nga Ljiljana Stipišić, Gjyqtare në Gjykatën e Lartë Penale të Kroacisë; Valon Kurtaj, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Kosovës; Klaudia Kuljuh nga organizata “Trial International” në Bosnjë dhe Hercegovinë; dhe Makifete Saliuka, avokate dhe përfaqësuese e viktimave në gjykatë, e angazhuar nga QKRMT në Kosovë. Paneli u moderua nga Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, anëtare e Bordit të QKRMT-së dhe ish-gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.



Paneli i dytë u përqendrua në temën “Avancimin e llogaridhënies për krimet e luftës të dhunës seksuale: roli dhe përgjegjësia e prokurorisë”. Diskutimet theksuan rolin kyç të prokurorisë në ndërtimin e rasteve të qëndrueshme dhe në sigurimin e hetimeve efektive, të pavarura dhe të bazuara në standarde profesionale dhe ligjore. U diskutua rëndësia e koordinimit ndërinstytucional, përfshirë bashkëpunimin me policinë, gjyqësorin dhe mekanizmat mbështetës për viktimat, si

një parakusht për hetime të suksesshme në raste komplekse të krimeve të luftës.

Një fokus i veçantë iu kushtua integritetit të qasjeve të ndjeshme ndaj traumës në punën hetimore dhe gjyqësore, duke synuar jo vetëm rritjen e cilësisë së procesit, por edhe shmangien e ri-traumatizimit të të mbijetuarve gjatë procedurave. Diskutimet trajtuan gjithashtu sfidat praktike që prokuroritë hasin në mbledhjen e provave pas një periudhe të gjatë kohore, mungesën e dëshmimeve të drejtpërdrejta dhe nevojën për përdorim më efektiv të provave mbështetëse dhe bashkëpunimit rajonal.

Paneli përbëhej nga Miroslav Dasović, Zëvendës i Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Qarkut në Osijek të Kroacisë; Tarik Crnkić, Prokuror në Departamentin Special për Krime Luftë në Bosnjë dhe Hercegovinë; Ilir Morina, Prokuror Special dhe udhëheqës i Departamentit për Hetimin e Krimeve të Luftës në Kosovë; dhe Leonora Selmani, Kryetare e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës. Paneli u moderua nga Mehmet Musaj, Senior Menaxher në QKRMT.

✦ IDENTIFIKIMI I SFIDAVE

Diskutimet gjatë konferencës evidentuan një sërë sfidash të përbashkëta rajonale që vazhdojnë të ndikojnë në avancimin e drejtësisë për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës. Pjesëmarrësit theksuan se, pavarësisht progresit të arritur në ndjekjen e rasteve të krimeve të luftës, mbeten ende pengesa të konsiderueshme në sigurimin e qasjes efektive dhe gjithëpërfshirëse në drejtësi për të mbijetuarit.

Në veçanti, u identifikuan këto sfida kryesore:

- ✦ **Mungesa e kompensimit efektiv për viktimat** – Që në fillim të diskutimeve, pjesëmarrësit theksuan mungesën e kompensimit efektiv si një nga sfidat më serioze në sigurimin e drejtësisë për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës. U ritheksua rëndësia e trajtimit të kompensimit si pjesë integrale e drejtësisë dhe jo si element dytësor i procesit penal.
- ✦ **Vështirësitë në sigurimin e provave në rastet e dhunës seksuale të luftës** – U theksua se kalimi i një periudhe të gjatë kohore nga kryerja e krimeve, mungesa e dokumentimit fillestar dhe ndjeshmëria e natyrës së rasteve vazhdojnë të paraqesin sfida serioze në mbledhjen dhe administrimin e provave. U diskutua gjithashtu rëndësia e përdorimit të qasjeve profesionale dhe të ndjeshme ndaj traumës gjatë marrjes së dëshmive.
- ✦ **Rreziku i ri-traumatizimit gjatë procedurave** – U theksua se të mbijetuarit shpesh përballen me forma të ri-traumatizimit gjatë intervistimeve, procedurave hetimore dhe proceseve gjyqësore. Në këtë kontekst, u nënvizua rëndësia e qasjeve të orientuara drejt viktimës dhe e krijimit të procedurave që garantojnë siguri, dinjitet dhe mbështetje adekuate për të mbijetuarit.
- ✦ **Nevoja për ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve profesionale të institucioneve të drejtësisë** – U identifikua nevoja për trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët e tjerë relevantë, me fokus në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, standardet ndërkombëtare dhe qasjet e ndjeshme ndaj traumës.



✦ REKOMANDIME

Bazuar në diskutimet dhe shkëmbimin e praktikave rajonale, konferenca rezultoi me këto rekomandime kryesore:

Hartimi dhe miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse shtetërore për trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë

Zhvillimi i një strategjie të koordinuar dhe afatgjatë do të adresonte në mënyrë të strukturuar hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e krimeve të luftës, përfshirë rastet e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin. U nënvizua se një qasje e tillë do të kontribuonte në forcimin e koordinimit institucional, përcaktimin e prioritetëve, rritjen e efikasitetit të mekanizmave të drejtësisë dhe garantimin e qasjeve më të orientuara drejt viktimës.

Garantimi efektiv i së drejtës për kompensim përmes aktgjyimit penal

Trajtimi i kompensimit si pjesë integrale e drejtësisë penale dhe jo si mekanizëm dytësor apo vetëm administrativ, ishte rekomandimet kyç të konferencës. Respektivisht, u rekomandua harmonizimi i praktikave vendore me standardet ndërkombëtare të cilat aplikohen edhe në rajon, në mënyrë që gjykatat penale të vendosin për kompensimin e viktimave brenda aktgjyimit penal. Kjo qasje shmang procedurat e dyfishta, ul barrën mbi viktimat dhe siguron realizimin e plotë dhe të menjëhershëm të të drejtave të tyre.

Harmonizimi i praktikave vendore me standardet ndërkombëtare dhe praktikat rajonale lidhur me reparacionet

U rekomandua forcimi i harmonizimit të legjislacionit dhe praktikës gjyqësore me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me praktikat e mira të zhvilluara në rajon, me qëllim krijimin e qasjeve më të unifikuara dhe më efektive në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale të luftës.

Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë dhe organizatave joqeveritare në mbështetjen e viktimave

Është vlerësuar se bashkëpunimi ndërinstitucional mbetet thelbësor për ofrimin e mbështetjes gjithëpërfshirëse për të mbijetuarit, përfshirë ndihmën juridike, mbështetjen psikosociale dhe orientimin gjatë proceseve gjyqësore.

Parandalimi i ri-traumatizimit përmes përdorimit të teknologjisë

U theksua rëndësia e përdorimit të mekanizmave proceduralë që minimizojnë nevojën për përsëritje të dëshmimeve dhe reduktojnë ekspozimin e të mbijetuarve ndaj përvojave ri-traumatizuese gjatë procedurave hetimore dhe gjyqësore. Prandaj, rekomandohet aplikimi sistematik i incizimit audio dhe video gjatë marrjes në pyetje të viktimave, me qëllim që këto dëshmi të përdoren në vijim gjatë procedurës gjyqësore.



Rishikimi i politikave ndëshkimore për proporcionalitet më të drejtë

Diskutimet evidentuan nevojën për politika ndëshkimore më konsistente dhe proporcionale me peshën dhe pasojat afatgjata të këtyre krimeve, duke kontribuar në forcimin e besimit në sistemin e drejtësisë dhe në luftimin e pandëshkueshmërisë.

Investimi i vazhdueshëm në trajnimin dhe specializimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve

U rekomandua avancimi i kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve të specializuara mbi trajtimin e rasteve të dhunës seksuale të luftës, standardet ndërkombëtare dhe qasjet e ndjeshme ndaj traumës dhe të orientuara drejt viktimës.

Adresimi i stigmës dhe fuqizimi i zërit të të mbijetuarve

Stigma dhe paragjykimet shoqërore vazhdojnë të mbeten ndër pengesat kryesore që i dekurajojnë të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës të kërkojnë drejtësi dhe mbështetje institucionale. Pjesëmarrësit vlerësuan nevojën për angazhim të vazhdueshëm institucional dhe shoqëror në luftimin e stigmës dhe mbështetjen e viktimave në kërkimin e drejtësisë.

Në sesionin përmbyllës u theksua rëndësia e vazhimit të shkëmbimeve profesionale rajonale dhe krijimit të mekanizmave më të qëndrueshëm të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale në rajon. U nënvizua se bashkëpunimi rajonal mbetet një komponent i rëndësishëm në avancimin e praktikave profesionale, forcimin e llogaridhënies dhe ndërtimin e qasjeve më efektive në trajtimin e krimeve të dhunës seksuale të luftës. Konferenca konfirmoi se qasja në drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës mbetet një proces kompleks që kërkon jo vetëm llogaridhënie, por edhe njohje institucionale, reparacione efektive dhe mbështetje të vazhdueshme për të mbijetuarit.



LI - DITA MEMORIALE E TË MBIJETUARV
4 APRIL - MEMORIAL DAY OF SURVIVORS

KONFERENCA RAJONALE

AVANCIMI I QASJES NË DREJTËSI
PËR TË MBIJETUARIT E DHUNËS SEKSUALE TË LUFTËS:
PËRQJEGJËSIA PENALE DHE E DREJTA PËR KOMPENSIM

MAKING JUSTICE

Organizuar nga:
Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës